

MARRËVESHJE ADMINISTRATIVE
PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES
MIDIS REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË ITALISË
NË FUSHËN E SIGURIMEVE SHOQËRORE,
NËNSHKRUAR NË ROMË MË 6 SHKURT 2024

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizime

Me qëllim zbatimin e kësaj Marrëveshjeje administrative :

- 1) termi “Marrëveshje” nënkupton Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Italiane në fushën e sigurimeve shoqërore, nënshkruar në Romë më 06.02.2024;
- 2) termi "Marrëveshje administrative" nënkupton këtë Marrëveshje administrative për zbatimin e Marrëveshjes, bazuar në nenin 19 të saj;
- 3) Termi “Palë kontraktuese” nënkupton palët e Marrëveshjes: Republikën e Shqipërisë dhe Republikën Italiane.

Neni 2
Institucionet kompetente

Institucionet kompetente të referuara në nenin 1, paragrafi 1, germa d) e Marrëveshjes, si për zbatimin e vetë Marrëveshjes, po ashtu edhe për zbatimin e Marrëveshjes administrative janë:

Për Republikën e Shqipërisë:

Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH), në lidhje me sigurimin për pleqërinë, invaliditetin dhe pensionin familjar (pasjetuesit), sigurimin e përfitimeve për sëmundje dhe barrë lindjen, dhe sigurimin e papunësisë.

Për Republikën Italiane:

Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore (INPS), në lidhje me sigurimin për invaliditetin, pleqërinë dhe pasjetuesit e punonjësit të siguar që mbulon punonjësit e sektorit privat, punonjësit publikë, të vetëpunësuarit dhe punonjësit e regjistruar në skema të veçanta të këtij sigurimi;

sigurimin e papunësisë dhe përfitimet në para në rast sëmundjeje, duke përfshirë tuberkulozin dhe barrëlindjen.

Neni 3

Organet ndërlidhëse

Në bazë të nenit 24 të Marrëveshjes, autoritetet kompetente të Palëve kontraktuese kanë caktuar si organe ndërlidhëse ndërmjet institucioneve kompetente të secilit shtet, referuar në nenin 1, paragrafi 1, shkronja e) të Marrëveshjes:

Për Republikën e Shqipërisë:

Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH) – Drejtoria e Përgjithshme - Tiranë

Për Republikën Italiane:

Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore (INPS) - Drejtoria e Përgjithshme - Romë

Neni 4

Kostot

Dispozitat e kësaj Marrëveshje Administrative nuk do të gjenerojnë asnjë kosto shtesë për Buxhetin e Shtetit të Republikës së Shqipërisë dhe Buxhetin e Shtetit të Republikës së Italisë, përveç atyre të parashikuara në Marrëveshje. Për realizimin e veprimtarive të parashikuara administrative, institucionet kompetente përkatëse dhe organet përkatëse ndërlidhëse do të operojnë brenda mundësive të buxhetit të tyre të zakonshëm, pa kosto shtesë.

PJESA II

DISPOZITAT E LEGJISLACIONIT TË ZBATUESHËM

Neni 5

Certifikata e mbulimit

- 1) Me kërkesë të palëve të interesuara, në rastet e përmendura në nenin 6, numrat 1) dhe 2) të Marrëveshjes, institucioni kompetent i Palës kontraktuese legjislacioni i të cilit është i zbatueshëm, do të lëshojë një certifikatë që tregon deri në cilën datë punonjësi do të vazhdojë të jetë subjekt i këtij legjislacioni.
- 2) Institucioni kompetent do t'i dorëzojë një kopje të kësaj certifikate të lëshuar personit të interesuar

ose punëdhënësit të tij dhe një kopje do ia dërgojë institucionit kompetent të Palës tjetër kontraktuese.

3) Certifikata e mbulimit duhet të kërkohej përpara fillimit të punës në territorin e Palës tjetër kontraktuese. Megjithatë, në rastet kur certifikata e lartpërmendur nuk lëshohet brenda afatit të mësipërm, në rrethana të jashtëzakonshme dhe të motivuara siç duhet, kërkesa përkatëse mund të merret në konsideratë me kusht që të mbërrijë brenda periudhës së vlefshmërisë së përcaktuar në atë certifikatë.

Neni 6

Ushtrimi i të drejtës së zgjedhjes

- 1) Personat e përmendur në nenin 7 të Marrëveshjes do të mund të ushtrojnë të drejtën e zgjedhjes brenda tre (3) muajve nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes ose, sipas rastit, brenda tre (3) muajve nga data e fillimit të punës në shtetin e punësimit.
- 2) Me kërkesë të personit së interesuar, institucioni kompetent i shtetit dërgues do të lëshojë një certifikatë që vërteton se punonjësi është subjekt i legjislacionit të kësaj Pale kontraktuese për periudhën në të cilën ai është i punësuar në misionin diplomatik dhe konsullatën në territorin e palës tjetër kontraktuese ose për periudhën në të cilën ai është në shërbim privat të titullarëve të këtij misioni apo këtij posti.
- 3) Kopje e certifikatës do të përcillet nga institucioni i Shtetit legjislacioni i të cilit është i zbatueshëm dhe zbatimin e të cilit i interesuari ka zgjedhur, tek institucioni kompetent i Palës tjetër kontraktuese.
- 4) Zgjedhja për zbatimin e legjislacionit të shtetit dërgues do të prodhojë efektet e saj nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes ose nga data fillimit veprimtarisë së punës, nëse është e mëvonshme.
- 5) Kontributet e sigurimeve shoqërore që janë paguar në skemat e sigurimeve të Palës tjetër kontraktuese, përpara fillimit të regjimit të zgjedhur, nuk do t'i transferohen institucionit kompetent të Palës kontraktuese, legjislacionit të së cilës i interesuari ka zgjedhur t'i nënshtrohet.
- 6) I interesuar mund ta ushtrojë të drejtën e zgjedhjes vetëm një herë.

PJESA III

PËRFITIMET E SËMUNDJES DHE BARRËLINDJES

Neni 7

Përfitimet në para në rast sëmundjeje (përfshirë tuberkulozin) dhe barrëlindjeje

Përfitimet për sëmundje (përfshirë tuberkulozin) dhe përfitimet e barrëlindjes, do t'i paguhen drejtpërdrejt të siguruarit nga institucioni kompetent i shtetit në të cilin është siguruar veprimtaria e tij e punës, siç është përcaktuar në nenet 5 dhe 23 të Marrëveshjes, mbi bazën e njohjes reciproke të certifikatave përkatëse.

Neni 8

Totalizimi i periudhave të sigurimit për të arritur të drejtën për përfitime në para për sëmundje (përfshirë tuberkulozin) dhe barrëlindje

Për qëllime të njohjes së të drejtës për përfitime në para për sëmundje (përfshirë tuberkulozin) dhe barrëlindje, nëse duhen marrë parasysh periudhat e sigurimit të maturuara sipas legjislacionit të Palës tjetër kontraktuese, institucioni kompetent i shtetit në të cilin është bërë kërkesa, do t'i përcjellë institucionit kompetent të Palës tjetër kontraktuese formularin përkatës në të cilin duhet të përcaktohen periudhat e sigurimit të maturuara sipas legjislacionit të asaj Pale tjetër kontraktuese.

PJESA IV PENSIONET

Neni 9

Pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe familjar

Në bazë të Pjesës III, kapitullit I të Marrëveshjes, me termin pensione nënkuptohen:

- Pensioni i pleqërisë ose i parakohshëm;
- Pensioni i invaliditetit;
- Pensioni familjar për pasjetuesit.

Neni 10

Pensioni sipas regjimit të totalizimit ndërkombëtar

1) Për qëllime të së drejtës për përfitime pensioni sipas neneve 11 dhe 13 të Marrëveshjes, periudhat e sigurimit ose ekuivalentet me to, të maturuara sipas legjislacionit të një Pale kontraktuese, kohëzgjatja minimale e të cilave është të paktën pesëdhjetë e dy (52) javë, do t'i shtohen periudhave të realizuara sipas legjislacionit të Palës tjetër kontraktuese, edhe nëse këto periudha kanë përcaktuar tashmë të drejtën e përfitimit të një pensioni sipas legjislacionit të kësaj Pale të fundit.

2) Në rastin e mbivendosjes së periudhave të sigurimit të realizuara në të dyja Palët kontraktuese, periudhat e mbivendosura do të merren parasysh vetëm një herë. Secili institucion do të marrë parasysh vetëm periudhat e mbivendosura të realizuara sipas legjislacionit që ai zbaton, duke përjashtuar periudhat e realizuara në bazë të legjislacionit të Palës tjetër kontraktuese.

3) Nëse nuk është e mundur të përcaktohet saktësisht koha se kur janë realizuar disa periudha të caktuara sigurimi sipas legjislacionit të një Palë kontraktuese, do të supozohet, se këto periudha nuk mbivendosen me periudhat e sigurimit të realizuara në bazë të legjislacionit të Palës tjetër kontraktuese.

Neni 11

Kërkesa për pension sipas regjimit ndërkombëtar

- 1) Personi i siguruar dhe, në rast vdekjeje, pasjetuesit e tij që kanë të drejtë për përfitime sipas neneve 11 dhe 13 të Marrëveshjes, mund të paraqesin kërkesën për pension pranë institucionit kompetent të shtetit të vendbanimit, i cili do të fillojë procedurën e komunikimit me institucionin kompetent të Palës tjetër kontraktuese. Në rast se aplikanti banon në një vend të tretë, aplikimi për pension mund t'i paraqitet institucionit kompetent të njëres prej Palëve kontraktuese.
- 2) Institucioni kompetent pranë të cilit është paraqitur kërkesa, do të plotësojë formularin përkatës të komunikimit, i cili duhet të tregojë datën e paraqitjes së kërkesës, të dhënat personale të aplikantit dhe sipas rastit, të dhënat e anëtarëve të familjes së tij, informacione në lidhje me çdo përfitim që mund t'i jetë dhënë aplikantit, si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për përcaktimin e së drejtës për pension. Institucioni kompetent pranë të cilit është paraqitur kërkesa, do t'ia përcjellë formularin e plotësuar institucionit kompetent të Palës tjetër kontraktuese, së bashku me formularin që vërteton periudhat e sigurimit të maturuara sipas legjislacionit të tij.
- 3) Institucioni kompetent i cili ka marrë një kërkesë për pension invaliditeti, do t'i përcjellë gjithashtu institucionit kompetent të Palës tjetër kontraktuese edhe relacionet mjekësore përkatëse. Informacioni i paraqitur në formularë duhet të verifikohet nga institucioni kompetent dërgues, në mënyrë që përcjellja e tyre, e miratuar dhe e nënshkruar siç duhet, të kryhet pa u shoqëruar me dokumentet origjinale.
- 4) Për të përcaktuar të drejtën e pensionit, institucioni kompetent që merr formularët do të verifikojë fillimisht nëse aplikanti e fiton të drejtën sipas regjimit të pavarur, pra duke marrë në konsideratë vetëm periudhat e sigurimit të realizuara sipas legjislacionit që ai zbaton. Nëse ky kusht nuk plotësohet, ai do të marrë parasysh shumën e periudhave të sigurimit me bashkimin e periudhave të realizuara sipas legjislacionit të të dyja Palëve kontraktuese.
- 5) Institucioni kompetent marrës, pasi ta ketë përgatitur praktikën, do të plotësojë nga ana e tij formularin e ngjashëm të komunikimit, duke dhënë informacion në lidhje me vendimin e marrë në lidhje me kërkesën, si dhe informacion në lidhje me masën e pensionit të llogaritur sipas dispozitave nga paragrafi 4) i këtij neni. Ai do të plotësojë gjithashtu formularin që vërteton periudhat e sigurimit të realizuara sipas legjislacionit të tij të zbatueshëm.
- 6) Pas marrjes së formularëve sipas paragrafit 5 të mësipërm, institucioni kompetent i përcaktuar në paragrafin 2) të këtij neni, do të përcaktojë, nëse është e nevojshme, të drejtën për pension që vjen nga mbledhja e periudhave të sigurimit të realizuara sipas legjislacionit të të dyja Palëve kontraktuese dhe do ia komunikojë vendimin institucionit kompetent të Palës tjetër kontraktuese.
- 7) Përfitimet do t'u ofrohen drejtpërdrejt nga institucioni kompetent përfituesve me banim në territorin e Palës tjetër kontraktuese.

Neni 12

Periudhat e sigurimit më pak se një vit

- 1) Me qëllim zbatimin e nenit 14 të Marrëveshjes, rritja e masës së përfitimit të pensionit që rezulton nga marrja përsipër e periudhave të sigurimit me kohëzgjatje më pak se një vit (52 javë) nga Pala

kontraktuese që e ofron atë, do të njihet nga data në të cilën këto periudha do të prodhonin efektet e tyre sipas legjislacionit të Palës tjetër kontraktuese në të cilën ato janë maturuar (përmeshja e kushtit të moshës së pensionit).

2) Nëse rritja e lartpërmendur do të duhet të zbatohet për një përfitim invaliditeti ose paaftësie, periudhat e sigurimit që zgjasin më pak se një vit do të kenë efekt nga data fillestare e fillimit të përfitimit, me kusht që institucioni kompetent i Palës tjetër kontraktuese sipas legjislacionit të të cilit ato janë maturuar, të ketë lëshuar një vendim refuzimi për përfitime të ngjashme, për shkak të mungesës së kushtit të kontributeve.

PJESA V

PËRFITIMET E PAPUNËSISË

Neni 13

Bashkimi i periudhave të sigurimit

Në bazë të nenit 18 të Marrëveshjes, nëse periudhat e punës me kontribute të realizuara në Palën tjetër kontraktuese janë të nevojshme për sigurimin e të drejtës së përfitimit të papunësisë, institucionit kompetent të Palës kontraktuese, ku këto periudha janë maturuar, do t'i kërkohet të dërgojë formularin ku të shënohen periudhat me kontribute, të vlefshme për të drejtën e përfitimit për papunësinë, si dhe periudhat për të cilat personit të interesuar i është dhënë përfitimi i papunësisë.

Neni 14

Dhënia e përfitimit

1) Për të përfituar pagesën e papunësisë sipas nenit 18, paragrafi 2 të Marrëveshjes, i interesuari duhet të paraqesë pranë institucionit kompetent, përveç aplikimit që përmban të gjitha të dhënat e kërkuara nga legjislacioni që ai zbaton, edhe një vërtetim në të cilin tregohen periudhat e sigurimit të papunësisë të realizuara si punonjës i punësuar sipas legjislacionit të Palës tjetër kontraktuese, të lëshuar nga institucioni kompetent për papunësinë e kësaj Pale të fundit kontraktuese.

2) Përfituesi i përfitimeve të papunësisë që shkon në Palën tjetër kontraktuese për të kërkuar punë, që të vazhdojë të marrë përfitimet sipas nenit 18, paragrafi 3 i Marrëveshjes, duhet t'i paraqesë institucionit kompetent të palës kontraktuese ku ai shkon, një vërtetim me të cilin institucioni kompetent i Palës kontraktuese, sipas legjislacionit të së cilës ai ka të drejtë për përfitime, vërteton:

- ruajtjen e të drejtës për përfitime;
- periudhën maksimale të ruajtjes së të drejtës;
- faktet që mund të ndryshojnë të drejtën për përfitime.

3) Nëse i interesuari nuk është në gjendje të paraqesë vërtetimin e përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, do të jetë përgjegjësi e institucionit kompetent të Palës kontraktuese ku i interesuari ka shkuar për të kërkuar punë, t'ia kërkojë atë institucionit kompetent të Palës tjetër kontraktuese.

4) Institucioni kompetent i Palës kontraktuese në territorin e së cilës ka shkuar personi i papunë do të kryejë vërtetimet e nevojshme, sikur ai të ishte një person i papunë që merr përfitime sipas legjislacionit që ajo zbaton.

PJESA VI DISPOZITA TË NDRYSHME

Neni 15

Shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi administrativ

1) Për qëllime të zbatimit të nenit 21 të Marrëveshjes, autoritetet kompetente, organet ndërlidhëse dhe institucionet kompetente të Palëve kontraktuese do të shkëmbejnë informacione dhe do të sigurojnë ndihmë të ndërsjellë dhe bashkëpunim falas, si të zbatonin ligjislacionet e tyre përkatëse kombëtare. Institucionet kompetente mund të hartojnë marrëveshje specifike tekniko-procedurale që parashikojnë procedura të përbashkëta telematike për aktivizimin e shkëmbimeve telematike të strukturuar të informacionit dhe të të dhënave, edhe duke zëvendësuar formularët e komunikimit në formë shkresore me letër.

2) Për qëllime të zbatimit të paragrafit 3 të nenit 21 të lartpërmendur të Marrëveshjes, Institucioni kompetent i njëres prej Palëve kontraktuese mund të kërkojë ekzaminime të nevojshme mjekësore nga institucioni kompetent i Palës së vendqëndrimit ose vendbanimit të të interesuarit.

3) Shpenzimet e kryera në lidhje me ekzaminimet e lartpërmendura, nëse kërkohen vetëm për dhënien e përfitimeve në ngarkim të Institucionit kompetent të Palës kontraktuese, në të cilin i interesuari nuk banon ose qëndron, do t'i rimbursohen nga ky i fundit Institucionit kompetent të Palës tjetër kontraktuese që ka kryer ekzaminimet.

4) Nëse ekzaminimet mjekësore kryhen edhe në interes të institucionit kompetent të vendit të qëndrimit ose vendbanimit të personit në fjalë, ky institucion kompetent do të përballojë shpenzimet dhe thjesht do t'i dërgojë një relacion për verifikimet institucionit kompetent të palës tjetër kontraktuese.

5) Rimbursimi i shpenzimeve mjekësore të përmendura në paragrafët 2) dhe 3) të këtij neni do të llogaritet në bazë të tarifave të aplikuara nga institucioni kompetent që ka kryer kontrollat mjekësore. Për këtë qëllim, ky institucion kompetent do të paraqesë një listë të shpenzimeve të kryera.

Neni 16

Pagesa e përfitimeve

1) Me qëllim zbatimin e nenit 27 të Marrëveshjes, Institucionet kompetente do t'ua paguajnë përfitimet drejtpërdrejt personave të përcaktuar në nenin 3 të Marrëveshjes ose përfaqësuesve të tyre, me kusht që ata të jenë të autorizuar ligjërisht për marrjen e pagesës, ose personave të deleguar prej tyre.

2) Çdo përfitim në para do t'i paguhet drejtpërdrejt përfituesit në monedhën e shtetit të cilit i përket institucioni kompetent që kryen pagesën, në përputhje me legjislacionin e tij të zbatueshëm, pavarësisht nëse ai banon në territorin e Palës tjetër kontraktuese apo në një shtet të tretë.

3) Në momentin e paraqitjes së kërkesës për përfitim, përfituesi duhet të deklarojë adresën e tij të banimit, emrin e bankës, IBAN-in dhe çdo lloj të dhëne tjetër bankare.

Neni 17

Rimbursimi i përfitimeve të dhëna tepër

- 1) Me qëllim zbatimin e nenit 28 të Marrëveshjes, nëse institucioni i njërës Palë kontraktuese i ka paguar një personi përfitime të dhëna tepër, ky institucion sipas kushteve dhe brenda caqeve të parashikuara nga legjislacioni që zbaton, mund t'i kërkojë institucionit të Palës tjetër kontraktuese, që jep përfitime për personin e interesuar, që ta mbajë shumën e dhënë tepër nga shumat e prapambetura ose nga pagesat në proces që i detyrohen atij personi.
- 2) Institucioni i Palës së fundit kontraktuese e bën mbajtjen në përputhje me legjislacionin që ai zbaton dhe ia transferon shumën e mbajtur institucionit që ka paguar përfitimet e dhëna tepër.

Neni 18

E drejta e zbatueshme

1) Kjo marrëveshje administrative do të zbatohet në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe atë italian, si dhe me të drejtën ndërkombëtar në fuqi. Përsa i përket Palës italiane, edhe në përputhje me detyrime që rrjedhin nga anëtarësimi i Italisë në Bashkimin Evropian.

2) Kjo Marrëveshje administrative nuk është një marrëveshje ndërkombëtare nga e cila mund të rrjedhin të drejta dhe detyrime sipas të drejtës ndërkombëtare. Asnjë klauzolë e kësaj Marrëveshjeje administrative nuk do të interpretohet dhe zbatohet si detyrim apo angazhim juridikisht i detyrueshëm për Palët kontraktuese përtej Marrëveshjes.

Neni 19
Dispozita përfundimtare

- 1) Kjo Marrëveshje administrative i fillon efektet në datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes.
- 2) Palët mund ta ndryshojnë me shkrim këtë Marrëveshje administrative me mirëkuptim të ndërsjellë.
- 3) Çdo mospërputhje në interpretimin dhe/ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje administrative do të zgjidhet në mënyrë miqësore me konsultime dhe negociata të drejtpërdrejta ndërmjet Palëve.


E nënshkruar në Romë, më datë 10 prill, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe italiane, të gjitha tekstet njësoj të barazvlefshme.

Për Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe
Inovacionit të Republikës së Shqipërisë



Olta Manjani
Zëvendësministre e Ekonomisë,
Kulturës dhe Inovacionit

Për Ministrinë e Punës dhe Politikave
Sociale të Republikës Italiane



Vincenzo Caridi
Shef i Departamentit për politikat e punës,
sigurimeve shoqërore, sigurimeve dhe
për shëndetin e sigurinë në vendet e punës